

ROLI I KLSH NË PËRMIRËSIMIN E QEVERISJESⁱ

nga Bedri Çoku

Qeverisja e mirë kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme publike me mendje të specializuara (audituesit e jashtëm publikë), për të siguruar se politika është zbatuar si qëllim në dobi të qytetarëve, se strategjitë janë plotësuar dhe performanca e përgjithshme e saj është brenda ligjeve dhe rregulloreve. Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) ndihmojnë pikërisht qeverinë, duke ushtruar mbikëqyrje të plotë dhe duke vlerësuar institucionet qeveritare nëse janë duke bërë pikërisht atë që janë planifikuar të bëjnë dhe fondet publike (mbi 3 miliardë euro çdo vit) a janë shpenzuar për qëllimin e menduar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e vendit ? Është gjithashtu përgjegjësi e SAI-t për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin në zbatimin e programeve të qeverisë, për të siguruar përputhshmërinë me standardet e mjedisit e për të promovuar qeverisjen e mirë. KLSH, si një SAI, që përpiket të reformohet vetë thellësisht, bazuar në standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, ka përparësi të punës së tij përmirësimin e qeverisjes. Këtë e realizon me rekomandimet që jep nga gjetjet e shkeljeve prej auditimeve.

Vetëm gjatë periudhës janar-maj 2013, institucioni ka çuar në prokurori 16 kallëzime penale për 44 nëpunës të administratës shtetërore. Por KLSH është i bindur se korrupsioni nuk mund të luftohet i vetëm. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për të rritur në një shkallë më të lartë luftën kundër korrupsionit, KLSH lidhi marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP, mars 2012), me Autoritetin e Konkurrencës (mars 2012), me Ministrinë e Financave (maj 2012), me Agjensinë e Prokurimit Publik (dhjetor 2012), me Departamentin e Administratës Publike (dhjetor 2012), me Institutin e Ekspertëve Kontabël

të Autorizuar (IEKA, dhjetor 2012), Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit (dhjetor 2012) dhe me Institutin “G&G Group” (dhjetor 2012). Këto marrëveshje janë të rëndësishme për institucionin, sepse mundësojnë bashkëpunimin me partnerë profesionalë, që po e ndihmojnë efektivisht në thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij. Në vitin 2011 marrëdhënia e KLSH me organin e akuzës kishte një rënie të dukshme (vetëm 6 kallëzime), gjithshka ndryshoi në këto një vit e gjysëm menaxhim, me synim sinergjine institucionale për të luftuar korrupsionin dhe përmiresuar qeverisjen. Me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në respektim të pavarësisë së institucioneve, KLSH mori nismën dhe nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit (qershor 2012), e cila pati ndikim tepër pozitiv. Rivitalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit KLSH - Prokurori, si dhe vëmëndja dhe mbështetja e Kryeprokurorit të ri, kanë bërë të mundur që krahas bashkëpunimit të afët e sistematik, kallëzimet e KLSH të vlerësohen maksimalisht nga ana e Prokurorisë. Por kjo nuk mjaftoi me kaq. Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhi marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë civile (prill 2012), me gjashtë organizata jo fitimprurëse më të spikatura në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës, siç janë: Lëvizja Alternative Civile, Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë, Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Transparency Internacional në Shqipëri dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri. Marrëveshjet u lidhën në zbatim të parimeve e orientimeve të përcaktuara në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t, me moton se ”... eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve” . Duke synuar kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH-së me këto shoqata, për vrojtme, prognoza dhe studime të përbashkëta, për pjesmarrje reciproke në seminare, simpoziume, konferenca, në luftën kundër korrupsionit, luftë e cila mund të ketë sukses vetëm me

punë të përbashkët në sistem, si dhe me rritjen e transparencës së institucioneve publike.

ⁱ Botuar në Gazetën “Republika” dt. 09 Qershor, 2013